



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Histori e teorive gjuhësore

Ngarkesa: 30 leksione, 10 seminare, 4 kredite.

Viti / Semestri : Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën Frënge “Gjuhë dhe Komunikim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshëm të lëndës: Të njihen etapat e evoluimit të mendimit mbi gjuhën, nga lashtësia deri në ditët e sotme; të njihen teoritë, shkollat, rrymat gjuhësore dhe dallimet mes tyre; të kuptohet roli i gjuhësisë teorike në përmirësimin e metodave dhe metodologjisë së mësimit të gjuhëve të huaja, duke bërë, kështu, dallimin mes gjuhësisë teorike dhe asaj të zbatuar.

Objektiva specifike të lëndës:

1. të njihet mendimi gjuhësor i lashtësisë (sidomos ai greko-latin);
2. të njihen disa aspekte të gjuhësisë krahasuese-historike të shek. XIX;
3. të njihet gjuhësia sosyriane: koncepti mbi gjuhën dhe gjuhësinë, dallimi mes gjuhës dhe ligjëritimit (langue/parole), teoria e shenjës gjuhësore, dallimi mes sinkronisë dhe diakronisë, sintagmës dhe paradigmës;
4. të njihen shkollat dhe rrymat gjuhësore të shek. XX si strukturalizmi, shkolla e Pragës, distribucionalizmi, gjuhësia gjenerative;
5. të njihen teoritë mbi ligjërimin dhe ato pragmatike.